


Projekt për arsimim akademik në teknologjinë e ushqimit

PRISHTINË, 17 JANAR ■ Universiteti i Prishtinës do të ndihmohet me një program të ri studimi të doktoratës, nëpërmjet projekti Tempus. Në një ceremoni të mbajtur në Fakultetin Juridik të UP-së, "Takimi Nismëtar, PhD në Shkenca të Ushqimit dhe Teknologji të Ushqimit", dhe në krijimin e kapaciteteve për reformë në PhD në Universitetin e Prishtinës, me qëllim që të mbështesë reformën në kurrikulë (plan-program) të programeve të doktoratës (PhD) dhe ngritjen e kapaciteteve në Universitetin e Prishtinës, në përputhshmëri me procesin e Bolonjës dhe me zhvillimet e fundit evropiane, me qëllim,

që të mbështetet integrimi i Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Kontraktues i këtij projekti është Universiteti i Gracit, kurse koordinatore është WUS Austria, ndërsa, përfitues direkt i projektit është Universiteti i Prishtinës. Përveç këtyre, partnerët tjerë të projektit janë edhe: Universiteti Teknik i Munihut (Gjermani), Universiteti i Granadas (Spanjë), Universiteti Vassa (Finlandë), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës, Agjencioni Kosovar i Akreditimit, Shërbimi Austriak i Studentëve, Unioni i Pavarur i Studentëve i UP-së dhe Lista Studentore Reforma. Projekti

në fjalë financohet nga Programi TEMPUS i Komisionit Evropian. But Dedaj, drejtor i zyrës së WUS Austria në Kosovë tha se ky projekt ka rëndësi për ndërkombëtarizimin e UP-së. "Rëndësia e këtij projekti, përfitues i të cilit është Universiteti i Prishtinës, përveç në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe reformës në kurrikulë, ka rëndësi të madhe edhe në ndërkombëtarizimin e Universitetit të Prishtinës", u shpreh Dedaj. Ndërkaq, Mujë Rugova, rektor i Universitetit të Prishtinës tha se ky program do të kontribuojë në arsimimin e eksperteve të rinj në teknologjinë e ushqimit. "Fillimi i këtij programi të



doktoratës do të kontribuoj në arsimimin dhe përgatitjen e eksperteve të rinj në fushën e teknologjisë së ushqimit. Përveç kësaj, qëllimi është që të krijohet një praktikë model

në Universitetin e Prishtinës ku ofrohen programe të doktoratës të cilat bazohen në standardët më të larta të Evropiane, në kurrikulë bashkëkohore e në trend me zhvillimet e fundit në shkencë, hulumtim shkencor, mobilitet të studentëve, ndërkombëtarizim dhe sigurim të cilësisë. Po ashtu, edhe Avdulla Alija, Drejtor i Zyrës për Arsim të Lartë në MASHT tha se Ministria e Arsimit, dhe veçmas UP po bëjnë një punë të madhe në procesin e konsolidimit të mekanizmave për të siguruar një arsim të lartë cilësorë, të krahasueshëm dhe konkurrent në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. ■ **F. Shala**